Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

## Shtojca 7

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT( te njejta per lotet 1 dhe 2)**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

e. *Kopje te certifikates elektronike per Fiskalizimin per tatimpaguesit qe perdorin Platformen Qendrore te Faturave*

f. *Kopje te certifikates elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje te vlefshme te Kontrates se lidhur me Shoqerine e Certifikuar per zgjidhjen software-ike ne perdorim, per tatimpaguesit qe leshojne faturat nepermjet zgjidhjes software-ike*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

### **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të disponojë kontrata të ngjashme për:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm të realizuar në një vlerë sa 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqes për kontrata të realizuara me ent publik:

a) Kontrate të lidhur me Autoritetin Kontraktor për punën e kryer.

b) Situacion përfundimtar.

c) Akt Kolaudimi

d) Certificate të marrjes në dorëzim të objektit.

**Per kontrata te realizuara me subjekte private duhet te paraqese:**

**Kontrata, situacion perfundimtar, fatura tatimore.**

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2020 lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore kudo ku operatori ekonomik ushtron aktivitet ne territorin Shqiptar sipas ekstraktit te QKB-se.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument nga Administrata Tatimore te deklarimit te xhiros vjetore për vitin e fundit 2020, ne vlere jo me te vogel se 50% e vleres se fondit limit.

**2.3 Për kapacitetin teknik :**

**2.3.1. Licenca profesionale si me poshte:**

**Kategoria:** Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale te lidhura me transportin rrugor

**Nenkategoria:** Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

**Kodi:** VII.3.B.1

**Lloji i kategorise:** Licence, grupi 3

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirembajtja e karrocereve, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/d Riparimi dhe mirembajtja e gomave, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove

2.3.4. Te kete ne sherbim dhe te deklaroje piken (at) e sherbimeve e riparimeve te mjeteve brenda teritorit te bashkise Sarande, ku shtrin aktivitetin Ndermarja e Ujesjelles Kanalizimeve Sarande, ose ne territorin e bashkive fqinje me bashkine Sarande, por me kusht qe, pika e servisit te mos jete me shume se 20 km larg nga qyteti i Sarandes .

## **2.. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT( per lotin 3)**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

*b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

*c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

*ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

*d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*e. Kopje te certifikates elektronike per Fiskalizimin per tatimpaguesit qe perdorin Platformen Qendrore te Faturave*

*f. Kopje te certifikates elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje te vlefshme te Kontrates se lidhur me Shoqerine e Certifikuar per zgjidhjen software-ike ne perdorim, per tatimpaguesit qe leshojne faturat nepermjet zgjidhjes software-ike*

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

### **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të disponojë kontrata të ngjashme për:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm të realizuar në një vlerë sa 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqes për kontrata të realizuara me ent publik:

e) Kontrate të lidhur me Autoritetin Kontraktor për punën e kryer.

f) Situacioni i perfundimtar.

g) Akti i Kolaudimit



h) Certifikate e marrjes ne dorezim te objektit.

**Per kontrata te realizuara me subjekte private duhet te paraqese:**

**Kontrata, situacion perfundimtar, fatura tatimore.**

**2.2.2** Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore per vitin 2020 lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore kudo ku operatori ekonomik ushtron aktivitet ne territorin Shqiptar sipas ekstraktit te QKB-se.

**2.2.4.** Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument nga Administrata Tatimore te deklarimit te xhiros vjetore për vitin e fundit 2020, ne vlere jo me te vogel se 50% e vleres se fondit limit.

**2.4 Për kapacitetin teknik :**

**2.3.1.Licenca profesionale si me poshte:**

**Kategoria:** Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale te lidhura me transportin rrugor

**Nenkategoria:** Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio

**Kodi:** VII.3.B.1

**Lloji i kategorise:** Licence, grupi 3

VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirembajtja e pjeseve mekanike dhe te motorit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirembajtja e impiantit elektrik, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

**2.3.2..** Operatori ekonomik duhet te vertetoje nje punesim mesatar i te pakten 2 personash, duke perfshire stafin e perhershëm dhe stafin menaxherial per periudhen Janar- Mars 2021.Per te vertetuar kete kriter operatorët duhet te paraqese: Vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e te siguruarve mujor; Formularet E-SIG 025 "Listepagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi" te konfirmuara nga administrata tatimore

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 8

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### Specifikimet teknike per proceduren e mirembajtjes se automjeteve

Kompania jone,zoteron keto automjete ,qe do te mirembahen dhe sherbehen sipas kesaj kontratre:



Sprinter 311 Cdi ,Viti 2001,Tipi 903 311, Nr. Shasise WDB9036221R333301



Fiat Ducato 2.8 JTD ,viti 2005,Tipi 244CPWN, Nr Shasise ZFA24400057749821



Hyundai IX35,Tipi JU81 2.0,Viti 2015,Nr I shasise TMAJU81VDFJ721421



Ford Ranger 2AB,double cab 2.2TDCi,150 HP,Nr I shasise 6FPPXXMJ2PDG35743, Viti 2014



Mitsubishi L200,Viti 2014, Nr Shasise MMCJNKB40FDZ25200 (AA091YP)



Mitsubishi L200,Viti 2014,Nr Shasise MMCJNKB40FDZ25133 (AA092YP)



Mitsubishi L200,Viti 2004, Nr Shasise MMBJNK7404D078290



NISSAN ,Viti 1999,Tipi CGUD22, NrShasise JN1CGUD22U0720721

Sherbimet qe do te kryhen ne keto automjete, jane te percaktuara specifikisht ne preventivin qe shoqeron kete procedure.Per zerat, qe I perkasin rreshtave te ngjyrosur ne preventiv, nuk kerkohet ,qe te jepet oferte nga pjesemarresi ne tender.Ne preventiv(oferte), do te plotesohen vetem kutite(qelizat) bosh, te pangjyrosura, me cmimet njesi per secilin ze, ne cecilin automjet.

Per te orientuar pjesemarresit ne tender, qe te hartojne sa me sakte oferten e tyre, sqarojme se;

Punimet per automjetin tip Sprinter zene rreth 14-15% te vleres totale te punimeve per automjetet.

Punimet per automjetin tip Fiat zene rreth 8-9 % te vleres totale te punimeve per automjetet

Punimet per automjetin tip Hyundai zene rreth 13-15% te vleres totale te punimeve per automjetet

Punimet per automjetin tip Ford zene rreth 10-11% te vleres totale te punimeve per automjetet

Punimet per automjetin tip Mitsubishi(AA091B) zene rreth 14%te vleres totale te punimeve per automjetet

Punimet per automjetin tip Mitsubishi(AA092B) zene rreth 11-13% te vleres totale te punimeve per automjetet

Punimet per automjetin tip Mitsubishi(viti 2004) zene rreth 15-17%% te vleres totale te punimeve per automjetet

Punimet per automjetin tip Nissan zene rreth 11 % te vleres totale te punimeve per automjetet

*Keto jane vlera orientuese; ofertuesi mund te mos I permbahet me rigorozitet ketyre vlerave, mjafton qe oferta e tij te jete ne vlere, brenda vleres limit per cmimin njesi dhe asaj totale, dhe sigurisht, te permbushe te gjitha kerkesat tona per cilesine e punimeve dhe sherbimeve.*

Pjesemarresit ne procedure duhet te kene parasysh se, per zerin “puntori”, per Sprinter-in jane parashikuar 96 ore pune ne vit, per Fiat-in 48 ore, per Hyundai-n 80 ore, dhe per secilin nga mjetet e tjera, nga 40 ore pune ne vit.

Per sherbimet ne rruge(karroatrec) per Sprinter-in jane parashikuar 2(dy) te tilla ne vit, kurse per mjetet e tjera nga 1(nje) i tille ne vit

Ne preventiv dhe ne keto specifikime teknike, jane paraqitur te gjitha te dhenat e automjeteve, si marka, tipi, viti I prodhimit, nr I shasisë, etj, me qellim qe ofertuesi, mbeshtetur ne to, por, edhe ne pervojen e tij, sigurisht, te kete mundesi te gjeje lehtesisht pjesen e kembimit, sasite llojet e lubrifikanteve dhe lengjeve te tjera, qe I nevojiten cdo automjeti, per te llogaritur ne menyre te qarte dhe te sakte, vleren njesi, por, ne njefare menyre, dhe ate totale te punimeve.

Sherbimet dhe riparimet, do te kryhen ne piken e sherbimit te kontraktuesit, nen mbikeqyrjen e nje perfaqesuesi te U.K.Sarande dhe per cdo sherbim do te mbahet nje dokumentacion perkates. Detajet e procesit te kryerjes se sherbimit dhe plotesimit te dokumentacionit, do te percaktohen ne menyre te hollesishme ne kontraten, qe do te lidhet me fituesin e kesaj procedure.

## Specifikimet teknike per mjetet

**Mjetet qe zoteron shoqeria jone dhe qe do te mirembahen sipas kesaj procedure jane:**



Automjet teknologjik per pastrimin e kanalizimeve te ujrave te ndotura tip Renault D16 MED, Motor DTI 5, Euro 6,176 kW.Ky eshte nje mjet kompleks, qe pervecse eshte nje automjet normal, eshte i pajisur edhe me pajisje dhe sisteme te tjera mekanike, si;

a.Pompe uji e presionit te larte e markes “PRATSSOLI”, tipi KS40, 226lit/min, 130 bar,55 kW. *Vaji qe do te perdoret per kete pajisje do te jete cdo lloj vaji hidraulik ISO VG 220 ose ekuivalent*

b.Pompe thithjeje e ujrave te ndotur e markes”Battioni Pagani”, tipi KTS 960, 16200lit/min,44 kW. *Vaji qe do te perdoret per kete pajisje do te jete “Battioni Pagani Vacuum Pump oil” ,”Eni Dicrea 100” ose ekuivalent*

c.Transmision(reduktor) per transmentimin e levizjes ne pompa, i markes “OMSI”, tipi PFT-PC4/3000, *Vaji qe do te perdoret per kete pajisje do te jete “Dexron II” ose ekuivalent*

d.Sistem hidraulik per ngritjen e rezervuarit, tubo per presion te larte, tubo per thithjen e mbeturinave, etj,

per te cilet duhet te parashikohen sherbime dhe mirembajtje, prandaj, ofertusi, duhet te kete parasysh qe duhet te jete i afte per te kryer edhe sherbime dhe riparime ne te tilla sisteme ose te kryeje sherbimet ne perfaqesine e “Renault” ne Shqiperi.Ne kete rast,shpenzimet shtese, per transport, karburant, etj,do te perballoven nga vete O.E.



Skrep,tip Volvo BL61B ,motor DT Volvo D5D CDE3 62 kW,qe perdoret kryesisht nga sektoret e mirembajtjes se rrjetit dhe kanalizimeve te ujrave te ndotur.Per kete mjet, do te kryhen sherbimet preventivuese te parashikuara dhe ndonje riparim i caktuar,sipas preventivit.



Hedhes,shkarkues mbeturinash te ngurta,tip Dumper Silla 1200 SN,motor Lombardini LDW 1204, 21 kW(28,5HP),qe perdoret kryesisht nga sektori i kanalizimeve. Ky mjet ka nevoje qe pervec sherbimeve preventivuese, si nderrime vaji, filtrash,grasatime,etj, te behen edhe disa sherbime ne motor, sipas preventivit.

Lubrifikantet si, vaj per motorat e mjeteve, qe do te perdoren ,do te jene te standartit SAE 10W40 ose 15W40,vaji hidraulik per pajisje hidraulike te paspecifikuara me siper , do te jete ISO VG 32 ose 46 dhe per transmisione , vaj SAE 75W90 ose 85W90, ose ekuivalente.

Ofertuesi duhet te kete parasysh se punimet per sherbimet dhe riparimet ne mjetin Renault D16 MED, zene rreth 74-75% te vleres totale te punimeve ne kete lot, pra per mjetet, ndersa punimet per mjetin skrep Volvo BL61B zene 8-10% dhe ato per mjetin tip Silla 1200SN, zene 15-18%.

Pjesemarresit ne procedure duhet te kene parasysh se, per zerin “puntori”, per mjetin “Renault” jane parashikuar 96 ore pune ne vit, per Skrepin “Volvo” dhe Dumperin “Silla” , nga 40 ore pune ne vit.+

*Keto jane vlera orientuese;ofertuesi mund te mos l permbahet me rigorozitet ketyre vlerave, mjafton qe oferta e tij te jete ne vlere, brenda vleres limit per cmimin njesi dhe asaj totale, dhe sigurisht, te permbushe te gjitha kerkesat tona per cilesine e punimeve dhe sherbimeve.*

Sherbimet dhe riparimet, do te kryhen ne piken e sherbimit te kontraktuesit, nen mbikeqyrjen e nje perfaqesuesi te U.K.Sarande dhe per cdo sherbim do te mbahet nje dokumentacion perkates. Detajet e procesit te kryerjes se sherbimit dhe plotesimit te dokumentacionit, do te percaktohen ne menyre te hollesishme ne kontraten, qe do te lidhet me fituesin e kesaj procedure.

**Specifikimet teknike te procedures se mirembajtjes se pajisjeve stacionere si gjeneratore dhe kompresore**



stacionin nr 5.

Motogjenarotori “TEHNOLINK”, me motor IVECO, model N45TM2A, tip F4GE0485A\*F650-504241371, 96 kW ,i Stacionit te Pompimit te Ujrave te Ndotur,nr 1, 2,4 dhe 5,Ksamil(3 cope te njejte).Nje gjenerator sherben per stacionet 1 dhe 2, nje per stacionin nr 4 dhe i fundit per



Motogjeneratori “TEHNOLINK” me motor Volvo Penta model TAD1642GE, 565 kW ,i Stacionit te Pompimit te Ujrave te Ndotur nr 6,Ksamil



Motogjeneratori tip Marelli(Tessari Group)me motor IVECO model F2BE0685A,7.8L, 265 kW,diesel,i Impiantit te Trajtimit te Ujrave te Ndotura.



Motogjeneratori tip SDMO,me motor John Deere model 6068HF120, 144 kW, i Stacionit te Pompimit te Ujrave te Ndotura



Kompresori " Bottarini" MSC43 me motor Lombardini LDW 1204

Pra, per keta motogjeneratore emergjence, jane parashikuar te behen kryesisht sherbimet preventivuese,te motorave te tyre, si sherbimet e nderrimit te vajrave dhe filtrave dhe ndonje sherbim tjeter ne sistemin elektrik apo ate te ushqimit me karburant. Duhet te theksohet se, duke qene se, keta gjeneratore, jane te instaluar neper stacione pompimi , sherbimet e tyre do te kryhen ne vendndodhje,prandaj, ofertuesi duhet t'a kete parasysh kete fakt, kur te hartoje oferten.Me poshte, paraqitet vendodhja(orientuese) e ketyre stacioneve te pompimit ne zonen tone te sherbimit.





Lubrifikantet dhe pjeset e kembimit qe do te perdoren, do te jene ne perputhje me marken , tipin e motorit ose ekuivalente me to.

Sherbimet per motogjeneratorin e stacioneve te pompimit nr. 1 dhe nr. 2, zene rreth 7-8% te vleres totale te sherbimeve,per gjeneratorin e stacionit te pompimit nr. 4, 7-8%, per ate te stacionit nr 5, 3-5 %, dhe per ate te stacionit nr.6, 18 – 23%, te gjithë keta ne Ksamil.

Sherbimet per motogjeneratorin e stacionit te pompimit te ujrave te ndotur, Sarande, zene 16-17% te vleres totale te punimeve, per ate te Impiantit te Trajtimit te Ujrave te Ndotur, 28 – 31 % dhe per kompresorin 12-16%.

*Keto jane vlera orientuese; ofertuesi mund te mos l permbahet me rigorozitet ketyre vlerave, mjafton qe oferta e tij te jete ne vlere, brenda vleres limit per cmimin njesi dhe asaj totale, dhe sigurisht, te permbushe te gjitha kerkesat tona per cilesine e punimeve dhe sherbimeve.*

Sherbimet dhe riparimet, do te kryhen , sic thame me siper, ne vendin ku ndodhen gjeneratoret, nen mbikeqyrjen e nje perfaqesuesi te U.K.Sarande dhe per cdo sherbim do te mbahet nje dokumentacion perkates. Detajet e procesit te kryerjes se sherbimit dhe plotesimit te dokumentacionit, do te percaktohen ne menyre te hollesishme ne kontraten, qe do te lidhet me fituesin e kesaj procedure

**KUJDES:**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

**Shtojca 11**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

**TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

**Shtojca 12**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15.**

**KUSHTET E PËRGJITHSHME  
Shërbimet –Kërkesë për propozim**

**Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbale të tilla që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si

hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
